



Të shtënat para Ministrisë së Tregtisë, Policia: Rasti po cilësohet si vrasje në tentativë

KRONIKA | October 10, 2022 - 18:53

SHPËRNDAJE:  

Policia e Kosovës ka dhënë detaje për të shtënat në rrugën “Arbnor e Astrit Dehari” në Prishtinë.

Sipas Policisë, ngjarja ka ndodhur sot rreth orës 15:40 dhe bazuar në informacionet e para dyshohet se një person nga një motoçikletë në lëvizje ka shtënë në drejtim të një veture.

Këtë e konfirmoi për “Zërin”, zëdhënësja e policisë për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti.

Ahmeti ka thënë se ky rast po cilësohet si “Vrasje në tentativë”.

“Rreth orës 15:40, policia ka marrë informatën për të shtëna me armë në rrugën Arbnor dhe Astrit Dehari në Prishtinë. Menjëherë pas marrjes së informatës policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që konsistojnë në hetimin e rrethanave që karakterizojnë ngjarjen. Bazuar në informacionet e para janë ngritur dyshimet se një person i dyshuar, nga një motoçikletë në lëvizje ka shtënë me armë zjarri në drejtim të një veture. Nuk raportohet për persona të lënduar. Hetuesit policor në koordinim me prokurorinë, ndërmarrin veprimet hetimore për ndriçimin e plotë të rastit i cili është cilësuar vrasje në tentativë”, thuhet ndër të tjera. /Zëri

Më të lexuarat



KRONIKA |  October 09, 2022
Sulmohet në Serbi nga persona të maskuar autobusi i linjës Zvicër – Kosovë



KRONIKA |  October 10, 2022
Bie nga traktori, vdes 2-vjeçari në Podujevë



KRONIKA |  October 09, 2022
Vdes 21-vjeçari me prejardhje nga Presheva që u aksidentua në Bern



KRONIKA |  October 09, 2022
Shoferja e mitur godet me veturë një femër në Prishtinë



KRONIKA |  October 10, 2022
Rreth 100 mijë euro me fajde, rrëfimi i dëshmitarit në Gjykatë ndaj tre të akuzuarve



KRONIKA |  October 10, 2022
Gruaja në Malishevë dyshohet se rrahu fëmijën e saj trevjeçar dhe burrin

Të rekomanduara



Prishtinasi thotë se u rrëmbye nga dy persona...

 October 11, 2022

Vrau për gjakmarrje bashkëfshatarin, 17-vjeçari nga Lezha dënohet me 8 vjet burg

KRONIKA |  October 11, 2022

Rrokulliset me traktor, vdes një person në Prizren

KRONIKA |  October 10, 2022

Arratiset nga qelia shqiptari i dënuar me burgim të përjetshëm në Greqi

KRONIKA |  October 09, 2022



Klinasi mbante nën kërcënim të armës...

 October 11, 2022

Konflikt mes dy familjeve në Prizren për pyllin që s'ishte i asnjërës

KRONIKA |  October 10, 2022

Bie nga traktori, vdes 2-vjeçari në Podujevë

KRONIKA |  October 10, 2022

Operacion ndërkombëtar kundër drogës, arrestohet një turk – dy shqiptarë në kërkim

KRONIKA |  October 09, 2022